

# **Takimi i Komisionit të Granteve**

(datë: 03 Shkurt 2017, e premte, 11:00-12:30)

## **Procesverbali i takimit:**

Me datë 03 Shkurt 2017, në sallën e takimeve kati 11 në Ministrinë e Financave, u zhvillua takimi i Komisionit të Granteve ku sipas agjendës u diskutua “Aprovimi i draft Raportit të përshtatshmërisë së financimit komunal për vitin 2016, përzgjedhja me short e anëtarëve të rinj të Komisionit të Granteve për katër kryetarë të komunave për vitin 2017, etj. Këtë takim e kryesoi Ministri i Financave z. Avdullah Hoti.

### **Pjesëmarrësit:**

Z. Avdullah Hoti, Ministër në Ministrinë e Financave, Agim Krasniqi, Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Arsim Bajrami, Ministër në MASHT, Izet Sadiku Zv. Ministër në MSH, Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL, Naim Ismajli, Kryetar i komunës së Shtimes/AKK, Ramadan Muja, Kryetar i komunës së Prizrenit, Salim Jonuzi, Kryetar i komunës së Dragashit, Sokol Bashota, Kryetar i Komunës së Klinës, Vladeta Kostiç, Kryetar i Komunës së Graçanicës, Salvador Elmazi, Drejtor i Departamentit të Buxhetit në MF, Sazan Ibrahim, Drejtor-AKK, Fetije Begolli, Udhëheqëse e departamentit në MAPL, Muharrem Shahini, Drejtor i Zyrës për Informim në MF, Jeton Kryeziu dhe Kimete Zekaj, anëtarë të Sekretarisë së Komisionit të Granteve në MF.

### **Agjenda - qëllimi i takimit:**

- Aprovimi i draft Raportit të përshtatshmërisë së financimit komunal për vitin 2016;
- Diskutim tjetër me interes në kuadër të përgjegjësisve ligjore të parapara me nenin 33 të Ligjit të Financave të Pushtetit Lokal;
- Përzgjedhja me short e anëtarëve të rinj të Komisionit të Granteve për katër kryetarë të komunave;
- Tjetër.

Kryetari i Bordit të AKK, z. Naim Ismajli dhe Drejtori Ekzekutiv i AKK, z. Sazan Ibrahim, u ftuan të marrin pjesë si mysafirë të takimit, meqë bëhej përzgjedhja e katër komunave të Kosovës si anëtarë të Komisionit të Granteve.

Takimin e hapi Z. Avdullah Hoti Ministër i Financave, me ç ‘rast i përshëndeti të pranishmit me mirëseardhje si dhe i informoi anëtarët e Komisionit të Granteve lidhur me Raportin e përshtatshmërisë së financimit komunal për vitin 2016, i cili dokument duhet të aprovohet në Qeveri deri me 31 mars të çdo viti kalendarik dhe për përzgjedhjen me short të katër (4) anëtarëve të rinj të Komisionit të Granteve për vitin 2016, në pajtim me nenin 32 pika 1, 2 dhe 3 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal.

Me pas fjalën ia kaloi Drejtorit të Departamentit të Buxhetit z. Salvador Elmazi, i cili prezantoi çështjet kyçe të adresuara në Draft Raportin e Përshtatshmërisë së Financimit të komunave për vitin 2016 dhe rekomandimet përkatëse. Me theks të veçantë nga z. Salvador Elmazi, u ngrit çështja e bartjes së kompetencave të zjarrfikësve, inspektorëve të tregut, atyre sanitar, etj. nga niveli lokal në nivelin qendror, fleksibiliteti i planifikimit të

shpenzimeve operative duke përjashtuar pagat dhe mëditjet dhe shpenzimit kapitale, projeksionet e të hyrave vetanake komunale të bëhen mbi baza reale duke vendosur një objektiv real të rritjes së të hyrave për çdo vit për çdo komunë, çështja e taksës së mbeturinave, etj.

Z. Arsim Bajrami theksoi se MASHT ka probleme në planifikimin e Grantit Specifik për Arsim duke marrë parasysh politikat ekzistuese si: ngritja e cilësisë në arsim, ndarja e granteve drejtpërdrejt nëpër shkolla, që mësimitdhënësve të ju sigurojmë që mos të largohen nga puna, pra të zhvillojmë politikat e punësimit edhe për pedagogë dhe psikologë në nivel të shkollave. Gjithashtu, MASHT është duke konsideruar në planin afatmesëm krijimin e një sistemi gradimi për mësimitdhënës në ciklet parauniversitare duke u bazuar në katër nivele gradimi me qëllim të stimulimit të ngritjes së cilësisë në arsim.

Z. Naim Ismajli theksoi se në këtë raport janë adresuar çështjet me interes për komunat në përgjithësi, gjithashtu theksoi se duhet të adresojmë edhe disa çështje tjera si:

- Çështjet që kanë të bëjnë me pushtetin lokal nuk janë zhvilluar praktika të mira në zbatim praktikë duke marrë parasysh investimet nga qendra në infrastrukturën arsimore, shëndetësore, rrugore, etj.;
- Çështjen e zjarrfikësve, ka kaluar si kompetencë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa buxheti ka mbetur në nivel komunal;
- Çështjen e pagesës së lehonisë të kaloj nga buxheti komunal në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- Ligji për paga të analizohet dhe të bëhen ligje për paga sipas sektorëve përkatës për arsye se sektorët e ndryshëm kanë specifika të ndryshme dhe nuk mund të përfshihen në një ligj;
- Çështja e fondit për qentë endacak si dhe
- Çështjen e menaxhimit të mbeturinave.

Znj. Rozafa Ukimeraj, theksoi disa çështje që rrjedhin për pushtetin lokal si: adresimi i financimit të Universitetit të Mitrovicës Veriore, të parashikohet kostoja financiare për Draft Ligjin për Kryeqytetin, të planifikohet buxheti për mirëmbajtjen e investimeve kapitale në komuna, etj.

Z. Ramadan Muja ngriti çështjen lidhur me ndërtimin e një shkolle të ekselencës të cilën e ka financuar Duka e Luksemburgut. Në lidhje me këtë qendër, z. Muja shtroi domosdoshmërinë e zgjidhjes së problemit të 39 punëtorëve të cilët janë larguar nga puna dhe ku janë punësuar punëtorë tjerë të rinj, kryetari kërkoj një zgjidhje për këtë çështje sepse mësimitdhënësit e larguar po trokasin çdo ditë në derën e zyrës së tij për zgjidhje të problemit të tyre. Z. Arsim Bajrami theksoi se javën që vjen do të bëjnë një vizitë në Prizren për të gjetur një zgjidhje për këtë problem.

Z. Sokol Bashota theksoi se duhet të gjendët zgjidhja sa i përket zjarrfikësve, lehonave, si dhe planifikimin e projeksioneve të të hyrave vetanake në komuna.

**Anëtarët e Komisionit të Granteve aprovuan Draft Raportin e Vlerësimit të Përshtatshmërisë së Financimit të Komunave për vitin 2016 me rekomandimet përkatëse.**

Gjatë vitit 2008-2016 të gjitha komunat e Kosovës kanë qenë anëtarë të Komisionit të Granteve sipas rotacionit. Prandaj, për vitin 2017 janë përfshirë në short të gjitha komunat e Kosovës për zgjedhjen e kryetarëve të ri anëtarë të komisionit të granteve sipas nenit 32 pika 2, e cila u zhvillua në dy faza dhe atë si vijon:

- Në fazën e parë ishte hedhja e shortit për përzgjedhjen e tre (3) anëtarëve të rinj nga kryetarët e komunave të Republikës së Kosovës dhe
- Në fazën e dytë ishte hedhja e shortit për përzgjedhjen e një (1) anëtari të ri nga kryetarët e komunave minoritare të Republikës së Kosovës.

#### **Komunat e përzgjedhura për vitin 2017 me short janë:**

- a) Kryetari i komunës së Klinës pas hedhjes së shortit përzgjedhi për anëtar të ri kryetarin e komunës së **Rahovecit**,
- b) Kryetari i Komunës së Dragashit pas hedhjes së shortit përzgjedhi për anëtar të ri kryetarin e komunës së **Klinës**,
- c) Kryetari i Komunës së Prizrenit pas hedhjes së shortit përzgjedhi për anëtar të ri kryetarin e komunës së **Ferizajt**, si dhe
- d) Përfaqësuesi i komunës së Graçanicës pas hedhjes së shortit përzgjedhi për anëtar të ri nga komunat me shumicë minoritare, Kryetarin e Komunës së **Zubin Potokut**.

Rekomandimet nga Komisioni i Granteve:

#### 1. Raporti i përshtatshmërisë së financimit komunal për vitin 2016

- MASHT të fokusohet në politikat arsimore dhe në cilësinë e arsimit, kurse komunat të fokusohen në infrastrukturën shkollore;
- Gradimi i arsimtarëve në planin afatmesëm të bëhet në katër (4) nivele dhe rrjedhimisht edhe niveli i pagave të përshtatet me këtë gradim;
- Centralizimi i kompetencave të shoqërohet me buxhet, si në rastet e zjarrfikësve, inspektorëve të tregut, etj.;
- Fondi i lehonisë të bartet nga komunat tek MPMS;
- Të hartohen ligje sektoriale për paga;
- Komunat të mbledhin taksën e mbeturinave, kurse çështja e ofrimit të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave të bëhet me kontratë shërbimi;
- Të zgjidhet çështja e financimit të Universitetit të Mitrovicës Veriore sepse nuk është paraparë buxheti për këtë institucion me ndarjet buxhetore;
- Projektioni i të hyrave vetanake të bëhet në përputhje me pritjet për të hyrat e rregullta, duke mos llogaritur të hyrat e jashtëzakonshme;
- Të rritet buxheti për arsim dhe shëndetësi sidomos për mallra dhe shërbime për mirëmbajtje.

#### 2. Raporti i përshtatshmërisë së financimit komunal për vitin 2016 të shërbej si bazë për hartimin e koncept dokumentit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal.